



Kamëz



Finalizohet operacioni policor i koduar “Valiasi”.

Falë ndërhyrjes së shërbimeve të patrullës të përgjithshme të Komisarariatit të Policisë Nr. 5 parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale.

Në pranga një 61-vjeçar, i cili kërcënoi për shkak të detyrës punonjësit e Bashkisë Kamëz.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pushkë dhe fishekë luftarakë.

Shërbimet e Komisarariatit Nr. 5 arrestuan në kuadër të operacionit policor të koduar “Valiasi”, shtetasin:

R. S., 61 vjeç, banues në Valias i ri, në Kamëz.

Ky shtetas është konfliktuar për shkak të detyrës me punonjësit e Bashkisë Kamëz, të cilët po kryenin punime në një tokë në kufi me tokën e shtetasit R. S. dhe gjatë momentit që ky shtetas po futej në banesë i ka kërcënuar me fjalë për jetën punonjësit e Bashkisë Kamëz.

Me marrjen dijeni për rastin, në vendngjarje kanë mbërritur menjëherë dy shërbime të patrullës dhe specialistë për parandalimin dhe hetimin e krimit, të cilët kanë parandaluar përshkallëzimin e konfliktit dhe gjatë kontrollit të banesës dhe ambienteve në pronësi të

këtij shtetasi, Policia gjeti një armë zjarri pushkë dhe fishekë luftarakë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit R. S., për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.

Anetaresohuni ne Forumin e LajmiFundit.al dhe diskutoni e postoni lirisht per te gjitha temat qe deshironi!

## **Bella Hadid's Private Jet Looks Incredible**

Crafthought | Sponsored

## **Goodbye 'Pawn Stars'? Chumlee Pleads Guilty**

Articles Stone | Sponsored

## **15 Foods That Naturally Unclog Arteries & Blood Vessels**

Articles Vally | Sponsored

## **These Celebrities Turned Heads With Their Red Carpet Looks**

Learn It Wise | Sponsored

## **Prince Harry Confirms Unfortunate News**

Rich Houses | Sponsored

## **Colorado Mom Adopts 2 Kids, Months Later She Learns Who They Really Are**

Articles Skill | Sponsored

## **This game will keep you up all night**